




REPUBLIKA E SHQIPËRISË




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

**DREJTORIA E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

Nr. 496 Prot.

Tiranë, më 03/11 /2020



FONDACIONI
SHOQËRIA
E HAPUR
PËR SHQIPËRINË

Nr. 1146 Prot.

Tiranë, më 27/10/2020

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE**

Sot më datë, ___ .10.2020, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Drejtoria së Ndhmës Juridike Falas, me adresë: Bulevardi "Zog I", pranë Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **Z. Ergys Qirici**

dhe

Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), me adresë Rr. Qemal Stafa, Nr. 120/2, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, **Z. Andi Dobrush**

Palët në këtë marrëveshje bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Baza ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në Kodin Civil, Pjesën V, Titulli I, Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” neni 8.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj marrëveshje është ofrimi i ndihmës juridike parësore sipas përcaktimeve në këtë marrëveshje.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë marrëveshje termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Ndihma juridike parësore” ka të njëjtin kuptim sipas nenit 3 të pikës ”b” të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. “Palët “ janë Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas dhe Fondacionit Shoqëria e hapur për Shqipërinë.
3. “Regjistri i kërkesave dhe vetë deklarimeve” është formati i regjistrimit i miratuar nga Ministri i Drejtësisë me Urdhër Nr. 225, datë 25.03.2019.
4. “Sistemi unik i të dhënave” është sistemi elektronik online për ngarkimin e të dhënave, i aksesueshëm nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Neni 4

Të drejtat dhe Detyrimet e OSFA

1. **Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, nëpërmjet Klinikës Ligjore në Shkodër** (më poshtë klinika ligjore) merr përsipër të ofrojë ndihmën juridike parësore sipas procedurave ligjore për dhënien e ndihmës juridike parësore të parashikuara në nenin 17 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. Klinika ligjore do të mbajë, plotësojë dhe përditësojë regjistrin e vetëdeklarimeve të personave që kanë aplikuar të përfitojnë ndihmën juridike parësore. Regjistri do të mbahet në mënyrë elektronike. Ngarkimi i të dhënave do të bëhet edhe në sistemin Unik të të dhënave.
3. Klinika ligjore do dërgojë të dhëna periodike çdo muaj Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar / përfituar ndihmën juridike. Të dhënat do të dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.
4. Përzgjedhja e studentëve që do të përfshihen në ofrimin e ndihmës juridike parësore pranë klinikës ligjore do të bëhet sipas rregullave të brendshme për funksionimin e Klinikës.
5. Klinika ligjore mund të japë opinionet, sugjerimet, të kërkojë informacione apo ndihmë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas për çështje /probleme që lidhen me ofrimin apo përmirësimin e ndihmës juridike parësore.

6. Klinika ligjore ndërmerr fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut veçanërisht informimin e studentëve të universiteti mbi kriteret dhe kushtet e përfitimit të ndihmës juridike parësore.

7. Klinika e ligjit ofron zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinika mban arkivin elektronik dhe është e pajisur me mjetet minimale të punës. Për atë që është e mundur Klinika, ofron shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standarteve të përcaktuara në Urdhërin Nr. 531 Prot., datë 25.11.2019 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikqyrjes nga Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndihmës Juridike”.

Neni 5

Të drejtat dhe Detyrimet e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

1. Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) do të ofrojë kushte për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë klinikës ligjore, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore.
2. Për atë që është e mundur do të sigurojë informacione, këshillime apo ndihmën e kërkuar nga klinika ligjore për zgjidhjen e problemeve me të cilat do të përballet kjo e fundit gjatë ofrimit të ndihmës juridike parësore.
3. Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka të drejtë të kërkojë nga klinika ligjore informacione apo të dhëna periodike.
4. Mbështet klinikat ligjore dhe me kërkesë të kësaj të fundit merr pjesë në fushata për ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut.


Neni 6

Komunikimi mes palëve

1. Palët bien dakord të shkëmbejnë informacione, të dërgojnë apo marrin të dhëna të ndryshme përmes postës elektronike apo çdo formë tjetër të parashikuar në ligj.
2. Për këtë qëllim palët do të caktojnë personat e kontaktit me të dhënat si më poshtë:
 - Për Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas: Personi i kontaktit Z. Ilberjan Durmishi nr. Cel. 0675500812; e-mail: ilberjan.durmishi@drejtesia.gov.al; dnjf@drejtesia.gov.al
 - Për klinikën ligjore: Personi i kontaktit Znj. Griselda Dama, nr. Cel. +355 67 629 4894, e-mail: griseldadama@gmail.com.
3. Në çdo rast palët njoftojnë për ndryshimin e të dhënave dhe personit të kontaktit.

Neni 7

Mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti



1. Palët marrin përsipër të ruajnë konfidencialitetin të dhënave apo informacioneve me të cilat janë vënë në dijeni gjatë dhënies së ndihmës juridike parësore.

2. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të kërkuesve të ndihmës juridike parësore do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 8

Ndryshimi dhe zgjidhja e marrëveshjes

1. Palët janë të lira të propozojnë ndryshimet e kushteve të kësaj marrëveshjeje.

2. Me njoftimin me shkrim, çdo palë në çdo kohë mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj marrëveshjeje pasi të këtë njoftuar paraprakisht palën tjetër.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që lindin mes palëve do të zgjidhen me mirëkuptim mes tyre. Nëse kjo nuk është e mundur palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit mes palëve.

Neni 11

Të ndryshme

1. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

2. Çështjet të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në këtë marrëveshje do të rregullohen sipas Pjesës V, Titulli I, të dispozitave të Kodit Civil të miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994, i ndryshuar.

PËR
DREJTORINË E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS

përfaqësuar nga

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ERGYS QIRICI



PËR
FONDACIONIN
SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË

përfaqësuar nga

DREJTORI EKZEKUTIV
ANDI DOBRUSHI

